



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**V E N D I M**

**Nr. 648, datë 2.10.2019**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.594, DATË 9.10.2018,  
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EMËRIMIN E KRYETARIT  
DHE TË ANËTARËVE TË KËSHILLIT DREJTUES TË FONDIT  
SHQIPTAR PËR ZHVILLIMIN E DIASPORËS”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr.32/2018, “Për Fondin Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

Në vendimin nr.594, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1 bëhen këto ndryshime:

Për pjesën e mbetur të mandatit, sipas pikës 4, të nenit 9, të ligjit nr.32/2018:

- i) Znj. Dajna Sorensen emërohet në vend të z. Elton Haxhi, si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
- ii) Znj. Mira Hoxha emërohet në vend të z. Andris Stastoli, si përfaqësues nga ministria përgjegjëse për punët e jashtme.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ 2.Emërohet znj. Dajna Sorensen, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat, kryetar i Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës.”.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**ED I R A M A**

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO**